



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr. 202, datë 11.06.2020**

**PËR**

**PËRSËRITJEN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË GJYQTARIT {...} NË  
GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË SHKODËR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, në vendimet e tij nr. 99, datë 21.06.2019, nr. 175, datë 11.09.2019 dhe nr.193, datë 04.06.2020, si dhe duke mbajtur në konsiderate dhënien e pëlqimit të gjyqtarit {...} me shkresën nr. 337/1 prot., datë 08.06.2020, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për një periudhë deri në 1 (një) vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 16.06.2020.
3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit z. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**